



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë _____.2025

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632,
DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvend, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____.2025

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2, paragrafi 3, pas togfjalëshit “...të Këshillit të Ministrave...” shtohet togfjalëshi “në zbatim të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të këtij ligji”.
2. Pas pikës 9, shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:
“10. Ndërtimet për qëllime publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, të financuara nga buxheti i njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 janar 2026.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI